

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “MONITORIMI I ZJARREVE DHE PARANDALIMI I DËMEVE NË FONDIN PYJOR TË EKONOMIVE PYJORE ROVË-LUNXHË, BALDUSHK, KRRABË- GURRË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

33195100-4 - Monitorë, 45312100-8 - Instalime sistemesh për alarm në rast zjarri

VLERA E FONDIT LIMIT:

58 333 131 (pesëdhjetë e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e tridhjetë e një)
Lekë Pa Tvsh.

506 451.98 (pesëqind e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e tetë) **Euro pa tvsh**
Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 21/02/2023 është 1 euro = 115,18 lekë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të Përgjithshme të shprehura më lart

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për për tre vitet e fundit, kur ky informacion është i mundur, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 90% e fondit limit të vënë në dispozicion.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2, të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020, 2021, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1) Kontrata të mëparshme të ngjashme të suksesshme të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Këto kontrata duhet të jenë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej min. 40% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2) Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar, i lëshuar për operatorin ekonomik ofertues, i cili duhet të përmbaje dhënien e të drejtave për produktet e mëposhteme:

1. Kamera Termale me dedektim zjarri dhe identifikim njerezish dhe mjetesh
2. Kamera të jashtëme IP, dedektim njerezish dhe Alarm
3. NVR 16 kanale Detekim njerezish
4. Switch POE 16 PORTA
5. Sistem Alarmi Wireless

6. Programi i monitorimit dhe i menaxhimit të kameras termale, videowall, kamera vëzhgimi

Në rastin e dokumenteve të lëshuara nga Distributor i Autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë detyrimisht edhe aktin e caktimit të distributorit nga prodhuesi përkatës. Autorizimi duhet në formën origjinal ose kopje e njehësuar me origjinalin, i përkthyer dhe i noteruar. Autorizimi i prodhuesit/distributorit duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e shoqërisë. Në rast se Autorizimi nuk i përmban këto të dhëna dokumenti do të konsiderohet i pavlefshëm për qëllim kualifikimi..

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet . Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6,8 të nenit 40, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2.3.3) Per te vertetuar perputhshmerine me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) **katalog ose skedë teknike nga prodhuesi i mallrave që oferton per produktet si më poshtë:**

Kamera Termale me dedektim zjarri dhe identifikim njerezish dhe mjetesh

Kamera të jashtëme IP, dedektim njerezish dhe Alarm

NVR 16 kanale Detekim njerezish

Switch POE 16 PORTA

Sistem Alarmi Wireless

Programi i monitorimit dhe i menaxhimit të kameras termale, videowall, kamera vëzhgimi

Argumentim : Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të nenit 40, pika 6 b, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.4) Operatori ekonomik duhet të provojë që produktet e përmendura në pikën 2.3.3 (me përjashtim të programit) janë prodhim që plotëson standartet e komunitetit evropian nëpërmjet paraqitjes së çertifikatës/deklarates së konformitetit (CoC).

Argumentim: Deklarata e konformitetit është një document i rëndësishëm, pasi na garanton se malli i ofertuar është në përputhje me standartet CE. Ky kriter është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të nenit 40, pika 6 c, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.5) Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka minimalisht për periudhën e 3-mujve të fundit 13 (trembedhjetë) punonjës të profilizuar si më poshtë:

- 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per Menaxhim Projektesh PMP ose ekuivalente ,per te cilin O.E duhet te paraqese certifikaten perkatese dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar,
- 1 (nje) punonjes te certifikuar ITIL Foundation Certificate in IT Service Managment ose ekuivalente , për të cilin operatori ekonomik duhet të paraqese çertifikatën përkatëse dhe të figuroj në listpagesa për periudhën e kërkuar,
- 1 (një) inxhinier ndertimi për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figurojë në listpagesa për periudhën e kërkuar,
- 2 (dy) inxhinier elektronik të certifikuar nga prodhuesi i sistemeve që do të ofrojë , per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomën perkatese ose vertetim diplome dhe certifikatën e trajnimit nga prodhuesi i sistemit të kamerave dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar,
- 1 (nje) inxhinier telekomunikacioni , per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomën perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar,

- 1 (nje) inxhinier elektrik , per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar,
- 2 (dy) specialist TIK , per te cilin O.E duhet te paraqesi diplomen perkatese ose vertetim diplome dhe te figuroj ne listpagesa per periudhen e kerkuar,
- Minimumi 4 (katër) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike ose teknik elektronik te certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve te kamerave, kjo e vërtetuar me listpagesat e 3-muajve të fundit sipas kodit perkates te profesionit dhe certifikatave te trajnimit nga prodhuesi

Për stafin e sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomat/Certifikatat perkatese
- Duhet te figurojne ne listepagesat e kompanise E-Sig per 3 muajt e fundit. .

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, neni 26 *“Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”*, pika 6 *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”*, **si më sipër.**

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* dhe nenit 40 pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit,duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar jane personat e drejperdrejte qe do te angazhohen nga O.E ne instalimin e pajisjeve, konfigurimin e tyre dhe integrimin ne rrjetet ekzistuese.

2.3.6) Per shkak se kjo eshte nje procedure Furnizim-Vendosje malli por do te kete nevoje edhe per kryerjen e punimeve per instalimin e mallit , Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me License Profesionale te leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise te kategorise :

NP-1 A Punime gërmimi në tokë

NS-8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

NS 13 A- Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5, gërma a të VKM nr.285, datë19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo licence eshte e lidhur menatyren dhe llojin e procedures se prokurimit e cila eshte F.V pra do te kryhen punime pervendosjen dhe instalimin e mallrave dhe tregojne profesionalizmin dhe aftesine tekniko-profesionale te operatoreve ekonomik per te kryer instalimet e nevojshme.

2.3.7) Operatori Ekonomik duhet të disponojë të paktën **2 (dy) automjete, furistrada pick-up** për realizimin e instalimeve per te cilët duhet të paraqesë dokumentat e meposhtem:

- Lejen e qarkullimit
- Policen e sigurimit
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Taksat vjetore

Ne rast se mjetet e lartpermendura jane marre me qera ofertuesi duhet të paraqesë ***Kontratën e marrjes me qira të mjetit***, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Argumentimi: Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kerkesa e mesiperme i sherben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme per te realizuar me sukses implementimin e kontrates brenda afateve.

2.3.8) Operatori Ekonomik duhet kete dhe te paraqesë certifikatat s Standarteve ISO si meposhte:

- a. Certificate: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë;
- b. Certificate cilesie sipas standartit SSH ISO/IEC 20000-1:2018 Teknologji Informacioni ;
- c. Certificate cilesie sipas standartit SSH EN ISO/IEC 27001:2017 Teknologjia e informacionit - Teknikat e sigurisë - Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ;
- d. Certificate cilesie sipas standartit Standartit ISO 50001:2011 per sistemet e menaxhimit te energjise.

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili nga operatoret duhet te disponoj certifikatat ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përmbushja e standarteve ISO është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e mallrave që parashikon kontrata.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4,pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur D.S.T-ve në S.P.E.